

AKT THEMELIMI

I

SHOQERISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

" Teleworks sh.p.k "

Sot, më datë 04.06.2024,

Erion Metushi, shtetas shqiptar, i ditëlindjes 06/11/1992, lindur në Shkodër, mbajtës i letërnjoftimit me Nr 035813795 dhe Nr. Personal J21106075U zotëron 1 kuotë duke përfaqësuar 100% te kapitalit, vendosi të themelojë një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar sipas legjislacionit shqiptar në fuqi dhe në përputhje me të.

NENI 1

Themelimi

Emri i shoqërisë është "**Teleworks sh.p.k**". Në të gjitha aktet që do të nxjerrë shoqëria drejtuar të tretëve dhe jo vetëm, do të shënohet emri "**Teleworks sh.p.k**".

NENI 2

Qëllimi i krijimit të Shoqërisë

Objektivi i shoqërisë do jetë aktiviteti në fushën e: Telemarketing- Call Center, përbrenda (inbound) dhe jashtë (outbound), brenda vendit dhe ndërkombëtare. Shërbime telemarketingu on line apo jo, të çdo forme dhe tipi, direkt apo indirekt. Shërbime marketing, shërbimesh apo produktesh duke mos u limituar vetëm në to. Promocione. Trajnime profesionale në të gjitha fushat e mësipërme duke mos u limituar vetëm në to. Shërbime të ofruara online nga shtëpia. Shoqëria kryen çdo aktivitet në raport me objektin e veprimtarisë apo të aftë për ta favorizuar.

NENI 3

Emri dhe vula e Shoqërisë

Shoqëria del në qarkullim me emrin "**Teleworks sh.p.k**" dhe kompania do ketë vulën e saj.

NENI 4

Objekti i veprimtarisë

Objektivi i shoqërisë do jetë: Telemarketing- Call Center, përbrenda (inbound) dhe jashtë (outbound), brenda vendit dhe ndërkombëtare. Shërbime telemarketingu on line apo jo, të çdo forme dhe tipi, direkt apo indirekt. Shërbime marketing, shërbimesh apo produktesh duke mos u limituar vetëm në to. Promocione. Trajnime profesionale në të gjitha fushat e mësipërme duke mos u limituar vetëm në to. Shërbime të ofruara online nga shtëpia. Shoqëria kryen çdo aktivitet në raport me objektin e veprimtarisë apo të aftë për ta favorizuar.

Erion Metushi



NENI 5

Selia e Shoqërisë dhe Afati

Selia e Shoqërisë ndodhet në qytetin e Shkodrës me adresë: Lagja "Vasil Shanto", Rruga "Ndoc Coba", Zona Kadastrale 8594, Nr. Pasurie 5/815.

Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj për një afat kohor të pacaktuar, duke filluar nga dita e regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

NENI 6

Kapitali i Shoqërisë dhe Ortakët

Kapitali i shoqërisë është në vlerën **100,000** (Njëqind mijë) lekë, i ndarë në 1 kuotë të vetme, ku kuota ka vlerën 100,000 lekë.

Ortaku i vetëm themelues i Shoqërisë Tregtare me emrin "**Teleworks sh.p.k**" zotëron kuotat në këtë shoqëri si më poshtë:

Erion Metushi, shtetas shqiptar, i ditëlindjes 06/11/1992, lindur në Shkodër, mbajtës i letërnjoftimit me Nr 035813795 dhe Nr. Personal *J21106075U*, zotëron 1 kuotë duke përfaqësuar 100% të kapitalit, ku një kuotë ka vlerën 100,000 lekë.

Kapitali themeltar do të shlyhet plotësisht në para nga Ortaku me themelimin e Shoqërisë. Përgjegjësia e ortakut shtrihet deri në shumën e kontributeve në kapitalin themeltar.

NENI 7

Organet Drejtuese

Duke ju referuar ligjit Nr 9901, datë 14/04/2008 "Për tregëtarët dhe Shoqëritë Tregtare", organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë:

Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve - Organi më i lartë vendimarrës.

Administratori - Organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë.

NENI 8

Administratori

Shoqëria administrohet nga Administratori, i cili zgjidhet për një mandat 5-vjeçar me të drejtë rizgjedhje.

Erion Metushi



NENI 9

Caktimi i Administratorit

Administrator caktohet **Z. Erion Metushi**, shtetas shqiptar, i ditëlindjes 06/11/1992, lindur në Shkodër, mbajtës i letërnjoftimit me Nr 035813795 dhe Nr. Personal J21106075U me një mandat 5 vjeçar dhe ka të drejta totale përfaqësimi të kompanisë.

Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga administratori, i cili ushtron këto të drejta në përputhje me Statutin e Shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.

NENI 10

Ortakët themelues mund të vendosin me vullnetin e tyre për pjesëmarrjen në Shoqëri të tjera dhe të krijojnë çdo lloj aktiviteti tjetër privat, me përjashtim të kufizimeve të përcaktuara me ligj.

NENI 11

Organizimi dhe funksionimi i shoqërisë, ngritje e degëve apo filialeve të saj do të bëhet në përputhje me dispozitat e ligjit përkatës dhe statutit.

NENI 12

Ortakët detyrohen të ruajnë sekretin e themelimit dhe të veprimtarisë së Shoqërisë. Të punësuarit dhe të ngarkuarit me drejtimin e Shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen të zhdëmtojnë shoqërinë për dëmet që i janë shkaktuar për faj të tyre gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

NENI 13

Mosmarrëveshjet për themelimin e shoqërisë zgjidhen nga ortakët themelues dhe kur kjo nuk arrihet, ato zgjidhen në Gjykata kompetente.

NENI 14

Akti i themelimit pasi u lexua nga Ortakët Themelues, nënshkruhet pa vërejtje. Ky Akt-Themelimi hartohet në 3 kopje në gjuhën shqipe.

ORTAKU THEMELUES

Erion Metushi

